

Programi



BASHKË

për PODUJEVËN

www.shpejtimbulliqi.com



BASHKË PËR **PODUJEVËN** 2026-2030



Shpejtim
Bulliqi

www.shpejtimbulliqi.com



Fjala e Shpejtim Bulliqit

Kandidat për Kryetar të Podujevës

Të nderuar qytetarë të Podujevës,

Në këto vite kemi ecur së bashku në një rrugëtim të sfidave dhe arritjeve, duke ndërtuar hap pas hapi një Podujevë më të zhvilluar e më dinjitoze. Falë besimit tuaj dhe përkushtimit tonë të përbashkët, kemi treguar se ndryshimi është i mundur kur ka vizion të qartë, punë të ndershme dhe bashkëpunim të sinqertë. Gjatë mandatit tonë, komuna jonë ka pësuar transformim në shumë fusha. Me qeverisje transparente dhe plane zhvillimore afatgjata kemi rikthyer besimin e qytetarëve në institucione dhe kemi sjellë investime të rëndësishme në arsim, infrastrukturë, shëndetësi, bujqësi, kulturë dhe ekonomi. Projektet e realizuara janë dëshmi e punës së palodhshme ekipore dhe e vendosmërisë për të mos u ndalur para asnjë sfide.



Sot, Podujeva është shembull i mirëqeverisjes lokale dhe i zhvillimit të qëndrueshëm. Në mandatin e ri, me besimin tuaj dhe me përkushtim të shtuar, jemi të vendosur të vazhdojmë rrugën e progresit në çdo fushë të jetës sonë të përbashkët. Ne do të punojmë çdo ditë që Podujeva të jetë pjesë e zhvillimit të zonës metropolitane së bashku me Kryeqytetin.

Programi i ri qeverisës është hartuar me kujdes, duke u konsultuar gjerësisht me qytetarë dhe ekspertë, për të siguruar që çdo objektiv të jetë i realizueshëm dhe çdo premtim të mbështetet në punë konkrete. Ne nuk premtojmë më shumë sesa mund të realizojmë – por as nuk ndalemi para pengesave.

Do të jemi gjithmonë pranë jush, me përlësi, përgjegjësi dhe vendosmëri, për të ndërtuar një Podujevë më të zhvilluar, më moderne dhe më të drejtë për secilin prej nesh.

PODUJEVA PËR ARSIMIN

Mësim gjithëditor për të gjitha shkollat

Investimi në arsim është baza e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror. Analizat dhe praktikat më të mira tregojnë se mësimi gjithëditor ka ndikim të drejtpërdrejtë në rritjen e cilësisë së arsimit, duke u ofruar nxënësve më shumë kohë për të mësuar, për t'u angazhuar në aktivitete krijuese dhe për të zhvilluar aftësi jetësore.

Gjatë mandatit tonë, Komuna e Podujevës do të zbatojë modelin e mësimi gjithëditor në të gjitha shkollat e komunës. Për të mundur këtë, do të investojmë në përmirësimin e infrastrukturës arsimore, përfshirë:

- **Ndërtimin e shkollave të reja moderne**
- **Shtimin e anekseve në shkollat ekzistuese**
- **Pajisjen e ambienteve mësimore me standarde bashkëkohore**

Këto investime do të krijojnë kushte optimale për zhvillimin e mësimi gjithëditor, duke garantuar që çdo nxënës të ketë qasje të barabartë në arsim cilësor.

1. Hapja e kuzhinës qendrore, ku çdo nxënës do ta ketë një shujtë të nxehtë brenda ditës
2. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Ibrahim Rugova"
3. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Xheladin Rekalu"
4. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Enver Maloku"
5. Ndërtimi i aneksit të shkollës "Dëshmorët e Kombit"
6. Ndërtimi i shkollës në fshatin Lluzhan
7. Ndërtimi i shkollës "Nuhi Gashi" në Bradash
8. Ndërtimi i shkollës "Jetullah Gashi" në Dobërdol
9. Ndërtimi i aneksit të shkollës në Kërpimëh
10. Ndërtimi i aneksit të shkollës në Gllamnik
11. Ndërtimi i aneksit të shkollës në Sfeqel
12. Ndërtimi i aneksit të shkollës në Siboc

Gjithëpërfshirja në edukimin parafillor

Edukimi parafillor i hershëm dhe i institucionalizuar është hallka e parë e sistemit arsimor dhe një element thelbësor për zhvillimin e plotë të fëmijës. Sigurimi i qasjes së barabartë në këtë fazë të arsimit është investim afatgjatë në të ardhmen e komunitetit.

Synimi ynë është gjithëpërfshirja e të gjithë fëmijëve në edukimin parafillor. Për ta arritur këtë, do të ndërtojmë dhe adaptojmë objekte të reja me qëllim hapjen e 10 çerdheve të reja në Komunën e Podujevës.

Gjatë mandatit do të hapen çerdhe në këto lokalitete:

1. Ndërtimi i çerdhes në qytet në lagjen e Dëshmorëve
2. Ndërtimi i çerdhes në qytet në rrugën "Hakif Zejnullahu"
3. Ndërtimi i çerdhes në qendër të qytetit
4. Ndërtimi i çerdhes në qytet, në afërsi të shkollës "Xheladin Rekaliu"
5. Hapja e çerdhes në fshatin Orllan
6. Ndërtimi i çerdhes në fshatin Lluga
7. Ndërtimi i çerdhes në Siboc
8. Hapja e çerdhes në fshatin Shajkoc
9. Hapja e çerdhes në fshatin Dumnicë
10. Hapja e çerdhes në fshatin Bradash
11. Hapja e çerdhes në fshatin Llapashticë
12. Hapja e çerdhes në fshatin Bajçinë
13. Hapja e çerdhes në Lupç

Arsimi i mesëm profesional i lidhur me ekonominë

Arsimi i mesëm profesional luan një rol jetik në zhvillimin ekonomik të komunës. Përgatitja e kuadrove të kualifikuar dhe të aftë për tregun e punës është thelbësore për të rritur konkurrueshmërinë dhe për të krijuar mundësi punësimi për të rinjtë.

Komuna e Podujevës do të zhvillojë investime dhe politika konkrete për ta lidhur arsimin e mesëm profesional me ekonominë lokale, në mënyrë që të rinjtë tanë të aftësohen dhe të inkuadrohen drejtpërdrejt në aktivitetet ekonomike, duke kontribuar kështu në një zhvillim të gjithanshëm ekonomiko-shoqëror.

PODUJEVA PËR ARSIMIN

Masat që do të ndërmerren:

- 1. Përfundimi dhe funksionalizimi i Qendrës së Kompetencës në zonën industriale.**
- 2. Hapja e drejtimeve të reja në shkollat profesionale, të përshtatura me kërkesat e tregut.**
- 3. Përshtatja e numrit të nxënësve sipas nevojave ekonomiko-shoqërore të komunës.**
- 4. Zbatimi i modelit të mësimi dual, duke kombinuar teorinë me praktikën në bizneset dhe institucionet partnere.**

Ky model do të sigurojë që arsimi të bëhet një motor real për zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Podujevës.

Digjitalizimi i shkollave

Gjatë mandatit, të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës do të digjitalizohen, duke e bërë teknologjinë pjesë thelbësore të procesit mësimor. Digjitalizimi do të përmirësojë cilësinë e mësimdhënies dhe të mësimnxënies, duke krijuar mundësi më të mëdha për zhvillimin e aftësive të nxënësve në përputhje me kërkesat e kohës.

Investimet kryesore:

- 1. Krijimi i një platforme digjitale me të gjitha lëndët mësimore, e qasshme për nxënësit dhe mësimdhënësit.**
- 2. Pajisja e çdo klase mësimore me tabelë digjitale, për një mjedis mësimor interaktiv dhe bashkëkohor.**

PODUJEVA PËR ARSIMIN

Mësim kabinetik në çdo shkollë

Në të gjitha shkollat e Komunës së Podujevës do të zbatohet modeli i mësimit kabinetik, ku çdo lëndë mësimore do të zhvillohet në kabinetin e saj të dedikuar. Ky sistem do t'i mundësojë nxënësve të lëvizin nga një kabinet në tjetrin, duke krijuar një mjedis më dinamik dhe tërheqës për të nxënë.

Kabinetet do të pajisen me mjete bashkëkohore të konkretizimit dhe kushte optimale për zhvillimin e procesit mësimor. Kjo qasje jo vetëm që rrit cilësinë e mësimdhënies, por edhe e bën mësimin më praktik dhe të lidhur ngushtë me realitetin e lëndës.

Ndërtimi i infrastrukturës sportive në shkolla

Sporti dhe rekreacioni janë thelbësorë për zhvillimin psiko-fizik të fëmijëve dhe të rinjve. Për të krijuar kushte të përshtatshme për zhvillimin e aktiviteteve sportive gjatë gjithë vitit, do të investojmë në ndërtimin e sallave të mbyllura sportive në shkollat dhe komunitetet tona.

Gjatë mandatit, do të ndërtojmë tre salla moderne të sportit, të pajisura me infrastrukturë bashkëkohore, për t'u shërbyer si qendra të aktivitetit fizik, garave sportive dhe zhvillimit të talenteve të reja.

PODUJEVA PËR ARSIMIN



- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në Kërpimëh
- Ndërtimi i sallës së edukatës fizike në Orllan
- Ndërtimin e sallës së edukatës fizike në Lluzhan
- Ndërtimin e sallës së edukatës fizike në Dumnicë

Shkolla verore

Gjatë pushimeve verore do të organizohet Shkolla Verore, e cila do t'u ofrojë nxënësve mundësinë të marrin pjesë në një gamë të gjerë aktivitete, përfshirë: aktivitete kulturore, sportive, kurse të gjuhëve të huaja, kurse të shkencave ekzakte dhe shumë të tjera.

Shkolla verore do të jetë në shërbim të fëmijëve të mërgimtarëve, duke ofruar orë të gjuhës shqipe dhe të historisë kombëtare, me synim forcimin e lidhjes së tyre me gjuhën dhe kulturën e vendit.

Ky program do t'u vijë në ndihmë edhe familjeve që, për shkak të angazhimeve në punë, nuk mund të qëndrojnë me fëmijët gjatë ditës, veçanërisht për nxënësit e klasave I–V, duke ofruar një mjedis të sigurt, edukativ dhe argëtues gjatë verës.

Bursa për student

Komuna e Podujevës do të rrisë fondet për bursa studentore, duke mbështetur kështu studentët e talentuar dhe familjet me të ardhura të kufizuara. Kjo nismë synon të lehtësojë qasjen në arsim të lartë dhe të inkurajojë përkushtimin ndaj studimeve, si një investim në të ardhmen e rinisë dhe zhvillimin e komunitetit tonë.

AMBIENT DHE URBANIZËM

Ambienti dhe urbanizmi janë elementë kyç dhe vlera të përbashkëta për qytetarët e Komunës sonë. Ne synojmë të zhvillojmë një qytet modern, i cili respekton normat më të mira urbanistike dhe siguron hapësira të gjelbra të bollshme. Një qytet i mirëplanifikuar dhe i gjelbëruar është baza e një cilësie të lartë jetese për të gjithë banorët dhe një vlerë që duhet të ruajmë dhe përmirësojmë vazhdimisht.

Qytet dhe komunë e planifikuar dhe urbanizuar

Miratimi i Planit Zhvillimor Komunal do të jetë një hap kyç për arritjen e synimeve tona zhvillimore. Ky plan do të mundësojë planifikimin strategjik dhe të qëndrueshëm të territorit të Komunës së Podujevës, në funksion të zhvillimit të përgjithshëm ekonomiko-shoqëror. Përmes këtij plani do të krijohen kushte të favorshme për investime, zhvillim infrastrukturor dhe përmirësim të cilësisë së jetës për qytetarët tanë.

Përmes këtij plani do të krijohen kushte të favorshme për investime, zhvillim infrastrukturor dhe përmirësim të cilësisë së jetës për qytetarët tanë.

PODUJEVA PËR MJEDISIN



Rishikimi i Hartës Zonale dhe planet rregulluese - Do të bëhet rishikimi i Hartës Zonale, në përputhje dhe harmonizim të plotë me Planin Zhvillimor Komunal, për të siguruar që zhvillimi i territorit të komunës të jetë i qëndrueshëm dhe i mirëplanifikuar.

Do të hartohen plane rregulluese të hollësishme për secilën pjesë të qytetit, me qëllim që ndërtimet dhe zhvillimi urban të realizohen sipas parametrave më të lartë urbanistikë dhe standardeve bashkëkohore.

Kjo qasje do të garantojë një qytet modern, funksional dhe të organizuar mirë, i cili i përgjigjet nevojave të qytetarëve dhe vizionit për zhvillim të qëndrueshëm.

Podujeva qytet i gjelbër

Synimi ynë është ta bëjmë Podujevën një qytet të gjelbër, me ambient dhe ajër të pastër, ku cilësia e jetës për qytetarët është në fokus.

Ky qëllim do të jetë parësor dhe do të inkorporohet në të gjitha politikat tona, duke filluar nga planifikimi urban, ndërtimi i infrastrukturës publike dhe zhvillimi i institucioneve, përmes zbatimit të politikave të qëndrueshme dhe miqësore me mjedisin. Synimi i jonë është një qytet i gjelbër, me ambient dhe ajër të pastër. Këtë synim do ta inkuadrojmë në të gjitha politikat tona, duke zbatuar një politikë të gjelbër, që përfshin planifikimin urban, ndërtimin e infrastrukturës publike dhe zhvillimin e institucioneve në mënyrë miqësore me mjedisin.

PODUJEVA PËR MJEDISIN

Për një qytet të gjelbër gjatë mandatit do t'i realizojmë këto investime dhe politika:

1. Ndërtimin e impiantit të ujërave të zeza, që përfundimisht do ta rregulloj problemin e ujërave të zeza në gjithë territorin e komunës, duke pasur ndikim të madh në pastrimin e lumenjve dhe tokës.

2. Funksionalizimin e trafikut urban, ku do të blihen autobus eko, që përveç që do të ofrojnë një shërbim të domosdoshëm e të munguar për qytetin, do të ndikojnë me më pak vetura në qytet e rrjedhimisht në ambient më të pastër

3. Ndërtimi i ngrohjes qendrore të qytetit - Gjatë mandatit do të realizohet ndërtimi i sistemit të ngrohjes qendrore për qytetin e Podujevës. Ky projekt është jashtëzakonisht i nevojshëm për përmirësimin e kushteve të jetesës së qytetarëve, duke siguruar një shërbim efikas dhe të qëndrueshëm ngrohjeje.

Përveç përfitimeve direkte për banorët, ngrohja qendrore do të ketë ndikim pozitiv edhe në ambient, pasi do të eliminojë përdorimin e ngrohjes individuale me djegie të drunjve, e cila lëshon substanca të dëmshme dhe kontribuon në dëmtimin e pyjeve.

Ky projekt do të jetë një hap i rëndësishëm drejt një mjedisi më të pastër dhe më të shëndetshëm për komunitetin tonë.

4. Parku qendror i qytetit, Parku Qendror "Parku te Pishat" do të përmirësohet dhe zgjerohet duke u kthyer në hapësirën kryesore rekreative të qytetit. Në këtë park do të ndërtohen terrene multifunksionale sportive, kënde lodrash për fëmijë, si dhe do të bëhet pyllëzimi i sipërfaqeve me pisha, jo vetëm në pjesën aktuale të parkut, por edhe në zonat përpara dhe prapa tij. Sipërfaqja me pisha do të zgjerohet për më shumë se pesë hektarë, duke krijuar një ambient të gjelbër dhe të shëndetshëm për gjithë qytetarët.

PODUJEVA PËR MJEDISIN

5. Ndërtimi i parqeve të reja në qytet, në planin zhvillimor komunal do të parashihen hapësira ku do të ndërtohen parqe të reja. Gjithashtu të gjitha oborret e institucioneve arsimore, shëndetësore, administrative do të rregullohen në konceptin e parqeve, ku do tushërbejnë qytetareve në vikende dhe pasdite si hapësira rekreative.

6. Mbjellja e drurëve dekorativë përgjatë rrugëve të qytetit - Për të krijuar një qytet më të gjelbër dhe me ajër më të pastër, gjatë mandatit do të mbillen 10,000 drurë dekorativë përgjatë rrugëve kryesore dhe atyre dytësore të Podujevës. Kjo iniciativë do të sjellë freski, do të përmirësojë cilësinë e ajrit dhe do të kontribuojë në krijimin e një ambienti urban më të këndshëm për të gjithë qytetarët.

7. Krijimi i korridoreve të gjelbërta në qytet - Për të lidhur hapësirat kryesore të gjelbërta në qytetin tonë, do të krijojmë një sistem korridorësh të gjelbërta që do të lidhë lumin Llap dhe sheshin e qytetit me parkun qendror. Kjo do të mundësojë krijimin e një rrjeti të ndërlidhur hapësirash të gjelbërta, duke rritur biodiversitetin dhe cilësinë e ambientit urban. Gjatë mandatit do të zhvillohen dhe mirëmbahen katër korridore të gjelbërta në pika kyçe të qytetit, të cilat do të shërbejnë si rrugëkalime natyrore për bimë, kafshë dhe banorë, duke sjellë freski dhe hapësira rekreative.

- **Korridori i gjelbër në rrugën "19 Qershori"**
- **Korridori i gjelbër në rrugën "Bajram Krasniqi"**
- **Korridori i gjelbër në rrugën "Bedri Bajrami"**
- **Korridori i gjelbër në rrugën "Besnik Restelica"**

PODUJEVA PËR MJEDISIN

8. Ndarja në burim i mbeturinave dhe riciklimi i tyre - me qëllim të krijimit të sistemit efikas të menaxhimit të mbeturinave, ato do të ndahen në burim në kategori të ndryshme me qëllim të riciklimit të tyre. Kështu përveç që do të ketë largim të mbeturinave ato do të kthehen edhe në sektor ekonomik përmes riciklimit të tyre.

9. Çdo shtëpi dhe biznes do të inkuadrohet në sistemin e mbledhjes së mbeturinave - Problematika e mbeturinave është edhe për arsyen se shumë shtëpi nuk janë të inkuadruara në sistemin e mbledhjes së mbeturinave. Përmes miratimit të rregullores komunale çdo familje dhe biznes do të inkuadrohet në sistemin e pagesave të mbeturinave dhe në mbledhjen e tyre nga kompania

INFRASTRUKTURA DHE SHËRBIMET PUBLIKE

Gjatë katër viteve të ardhshme do të investojmë në projekte infrastrukturore me qëllim ndërtimin e një komune të zhvilluar e të barabartë që ofron mundësi për të gjithë qytetarët. Një nga projektet madhore është dhe nisja e punës në bashkëpunim me qeverinë qendrore për funksionalizimin e hekurudhës Podujevë - Prishtinë dhe lidhjen e ardhshme të saj me rrjetin hekurudhor Prishtinë - Durrës. Në kuadër të mandatit tonë, do të realizojmë projektet dhe politikat e mëposhtme:

1. Furnizim me ujë të pijes 24 orë – Furnizimi i rregullt me ujë të pijshëm për të gjithë qytetarët e Komunës së Podujevës do të sigurohet gjatë mandatit. Përfundimi i ndërtimit të liqenit të Pollatës dhe fabrikës për përpunimin e ujit, së bashku me investimet në rrjetin e ujësjellësit, do të japin zgjidhje përfundimtare për këtë nevojë jetike, duke garantuar ujë të pastër dhe të mjaftueshëm për komunitetin tonë.

2. Ndërtimi i rrugëve unazore të qytetit – Ndërtimi i rrugëve unazore të qytetit do të jetë një nga prioritetet kryesore të mandatit, me synim përmirësimin e qarkullimit dhe lidhjes ndërmjet lagjeve dhe zonave të ndryshme urbane.

PODUJEVA PËR INFRASTRUKTURËN

Gjatë kësaj periudhe, do të realizohet ndërtimi i rrugës lidhëse mes rrugëve “Zahri Pajaziti” dhe “Skënderbeu”, rrugës lidhëse mes “28 Nëntori” dhe “Xhemail Mustafa”, rrugës lidhëse mes “28 Nëntori” dhe “Skënderbeu”, si dhe rrugës nga Zona Industriale drejt magjistrales.

3. Rikonstruimi i të gjitha rrugëve ku është e nevojshme në fshatra dhe në qytet - gjatë viteve janë ndërtuar shumë rrugë në fshatra dhe në qytet dhe tani shfaqet nevoja për renovimin e tyre dhe të gjitha këto do të mirëmbahen në mënyrë që të jenë në gjendje të rregullt vazhdimisht, që nënkupton mbylljen e gropave apo shtresëzimin e ri varësisht nga nevoja.

4. Rregullimi i rrjetit të trafikut urban të qytetit - do të bëhet riorganizimi i rrugëve në bazë të studimit i cili do përcaktojë mënyrën më të mirë të organizimit të komunikacionit, me qëllim të lehtësimit të lëvizjes posaçërisht në pjesën qendrore të qytetit.

5. Ndërtimi i shtigjeve të biçikletave - Ndërtimi i një rrjeti të integruar shtigjesh për biçikleta në të gjithë qytetin do të krijojë mundësi të reja dhe do të nxisë përdorimin e këtij mjeti ekologjik të transportit. Ky projekt do të ndikojë pozitivisht në mjedis, do të lehtësojë komunikacionin dhe do të kontribuojë në përmirësimin e shëndetit të qytetarëve.

PODUJEVA PËR INFRASTRUKTURËN

6. Rregullimi i parkingjeve – Rregullimi i parkingjeve në qytet do të realizohet duke ofruar hapësira të dedikuara parkimi, pa penguar lëvizjen e këmbësorëve në trotuare. Ky proces dotë përfshijë organizimin e hapësirave ekzistuese dhe ndërtimin e parkingjeve nëntokësore, me synim krijimin e një qarkullimi më të rregullt dhe funksional në zonat urbane.

7. Rregullimi i shtretërve të lumenjve – Rregullimi i shtretërve të lumenjve, përfshirë lumin Llap dhe lumenjtë e tjerë në territorin e komunës, do të realizohet gjatë dy viteve të para të mandatit. Ky projekt synon që lumenjtë të shndërrohen në hapësira të dobishme dhe atraktive për qytetarët, duke eliminuar rrezikun e vërshimeve të shpeshta dhe duke përmirësuar sigurinë dhe estetikën e mjedisit.

8. Mirëmbajtje ditore e të gjitha rrugëve të qytetit, përmes ndërmarrjes publike lokale EKO LLAPI të cilën e kemi themeluar dhe funksionalizuar do të bëhet pastrimi dhe larja e të gjitha rrugëve të qytetit.

PODUJEVA PËR BUJQËSINË



BUJQËSI

Bujqësia përbën një sektor jetik për komunën tonë, duke punësuar një numër të konsiderueshëm banorësh dhe duke siguruar ushqimin për sofrat tona. Investimi në këtë ektor, përmes rritjes së efikasitetit dhe efijencës, kontribuon drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe përmirësimin e mirëqenies së popullsisë. Prodhimi i produkteve bujqësore vendore me cilësi të lartë është po ashtu thelbësor për sigurinë kombëtare dhe shëndetin e qytetarëve.

Gjatë mandatit do të realizojmë investime dhe ndjekim këto politika për zhvillimin e sektorit të bujqësisë:

1. Ndërtimi i sistemit të ujitjes së tokave bujqësore, për ndërtimin e sistemit të ujitjes së tokave Komuna e Podujevës gjatë mandatit do të investon 2 milion euro, këto së bashku me ndërtimin e Liqenit të Pollatës, ku janë të planifikuara dhe gypat e ujitjes dhe përmes burimeve nëntokësore, tokën bujqësore në gjithë territorin do ta vejme në sistem të ujitjes

2. Ndërtimi i Parkut Industrial Bujqësor në Sfeqël - Në një sipërfaqe prej gjashtë hektarësh do të ndërtohet parku i parë industrial bujqësor në Kosovë, një koncept i aplikuar me sukses në vendet e zhvilluara industriale. Ky park do të përfshijë sera moderne për kultivimin e perimeve gjatë gjithë vitit dhe do të jetë i pajisur me të gjithë infrastrukturën e nevojshme për prodhim dhe shpërndarje efikase.

PODUJEVA PËR BUJQËSINË

3. 4 milion euro grante e subvencione për bujqit, gjatë mandatit, ku do të mbështesim me subvencione e grante sektorët si:

Blegtoria, Perimtaria, Pemëtaria Drithërat, Bimët mjekësore-aromatike etj.

4. Subvencionim për blegtorët për çdo litër të qumështit të prodhuar - Të gjithë blegtorët do të mbështeten financiarisht për çdo litër qumështi të prodhuar. Kjo masë do të ndihmojë fermerët ekzistues dhe do të inkurajojë fermerët e rinj të investojnë në blegtori. Investimi në këtë sektor jo vetëm që rrit prodhimin, por ka ndikim pozitiv edhe në zhvillimin e sektorëve të tjerë të bujqësisë dhe në të gjithë zinxhirin e prodhimeve ushqimore.

SHËNDETËSI

Shëndetësinë e shohim si një të drejtë themelore të çdo qytetari, të cilën duhet ta gëzojnë të gjithë, si një shërbim i domosdoshëm dhe i patjetërsueshëm. Qeverisja e Lëvizjes VETËVENDOSJE! do të garantojë shërbime cilësore dhe gjithëpërfshirëse në shëndetësinë primare.

Gjatë mandatit të kaluar kemi përmbyllur ndërtimin e infrastrukturës dhe kemi realizuar investime të rëndësishme, ndërsa në mandatin e ardhshëm do ta avancojmë shërbimin shëndetësor në të gjitha aspektet.

Në këto katër vite do të zbatojmë këto politika:

E-Mjekësia – Do të aplikojmë shërbimin e-mjekësisë, ku përmes një platforme digjitale, mjekët do t'u japin këshilla dhe udhëzime pacientëve gjatë procesit të kurimit të tyre. Ky shërbim do t'i ndihmojë pacientët të marrin disa shërbime shëndetësore pa qenë nevoja të vizitojnë fizikisht qendrat e mjekësisë familjare

1. Shërbimi shtëpiak shëndetësor - Ky shërbim ka rezultuar shumë i suksesshëm dhe i dobishëm për qytetarët. Gjatë mandatit, do ta avancojmë duke rritur numrin e stafit mjekësor të dedikuar për të. Të gjithë pacientëve që kanë nevojë për këtë shërbim do t'u ofrohet kujdes i shpejtë dhe cilësor, direkt në shtëpitë e tyre.

PODUJEVA PËR SHËNDETËSINË



2. Shërbime të reja shëndetësore - do të ofrohen edhe shërbime të reja shëndetësore të cilat nuk janë ofruar deri tani në shërbimin shëndetësor primar në Komunën e Podujevës, e që janë shërbime shumë të nevojshëm për qytetarët si:

- **Shërbimi i fizioterapisë**
- **Shërbimi i logopedisë**
- **Shërbime psikologjike**
- **Shërbime sociale**

5. Zonimi i Qendrave të Mjekësisë Familjare, do të bëhet ndarja në zona e Qendrave të Mjekësisë Familjare dhe çdo qytetar do ta ketë të përcaktuar qendrën dhe mjekun familjar, kjo do të ndikoj në sistem shëndetësor më efikas dhe në shërbime cilësore më të mira.

6. Furnizim me barna dhe pajisje mjekësore - Qendrat e mjekësisë familjare do të jenë të furnizuara me të gjitha materialet e nevojshme mjekësore dhe me pajisje moderne shëndetësore, me qëllim të ofrimit të shërbimeve cilësore shëndetësore.

7. Subvencione për pacientet me sëmundje kronike - pacientet me sëmundje kronike dhe me gjendje jo të mirë financiare do të subvencionohen nga komuna. Për këtë çdo vit do të ndahen nga 300 mijë euro.

PODUJEVA PËR EKONOMINË



EKONOMI

Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet që të aplikojë modelin ekonomik të shtetit zhvillimor, ku shteti luan një rol aktiv në ekonomi dhe rritjen ekonomike e kthen në mirëqenie të përgjithshme.

Në kuadër të kompetencave komunale do t'i ndjekim këto parime dhe gjatë mandatit tonë do t'i realizojmë këto investime dhe do të ndjekim këto politika:

1. Funksionalizimin e Zonës Industriale - është themeluar Zona Industriale e Podujevës, ku janë shpronësuar afër 30 hektar tokë prej AKP-se dhe janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme për themelimin, tani jemi në fazën e fillimit të ndërtimit të infrastrukturës së nevojshme për funksionalizim e tij.

Kjo zonë industriale do t'i ketë 30 hektar, ku janë të planifikuara 51 parcela që do të shërbejnë për realizimin e investimeve në sektorin e prodhimit nga investitorët. Funksionalizimi i Zonës Industriale është projekti më i rëndësishëm në historinë e këtij qyteti, në funksion të zhvillimit industrial që është themeli i zhvillimit ekonomik dhe shoqëror.

2. Ndërtimi i parkut teknologjik - Në hapësirën e Zonës Industriale së bashku me shkollën profesionale do të ndërtohet edhe Parku Teknologjik, që do të shërbejë për bizneset dhe individët si hapësirë për ushtrimin e aktivitetit të tyre në lëmin e shërbimeve teknologjike.

PODUJEVA PËR EKONOMINË

Shërbimet teknologjike janë një sektor me mundësi zhvillimi dhe Kosova ka mundësi të eksportoj shërbime, duke i pasur parasysh që për disa shërbime ka përparësi krahasuese në tregun ndërkombëtar, andaj ndërtimi i këtij parku teknologjik do jetë ndihmesë e madhe për zhvillimin e këtij sektori.

3. Subvencione për bizneset prodhuese, ku bizneseve prodhuese të cilat investojnë në makineri prodhuese do të mbështeten me 20% të vlerës së investimit të tyre duke ndihmuar kështu në rritjen e prodhimit vendor

4. Çdo familje me një anëtar të punësuar, komuna do të mbështesë familjet pa asnjë anëtar të punësuar, duke siguruar punësimin e një anëtari të tyre. Kjo do të realizohet përmes subvencionimit të pjesës së pagës ose përmes punësimit në punët publike në ndërmarrjet publike lokale.

5. Mbështetje për gratë ndërmarrëse në prodhim – Gratë që fillojnë biznes në fushën e prodhimit do të përkrahen nga Komuna përmes subvencioneve, me qëllim nxitjen e sipërmarrjes femërore dhe fuqizimin ekonomik të tyre.

6. Pronat komunale në funksion të zhvillimit – Me Planin Zhvillimor Urban shumë prona komunale do të destinohen për investime në industri dhe aktivitete tjera ekonomike dhe këto prona do të jepen në shfrytëzim për bizneset.

KULTURË DHE SPORT

Kultura është pjesë e rëndësishme e shoqërisë, niveli i zhvillimit të kulturës është treguesi i nivelit të kombit. Kultura kombëtare na jep ndjenjën e përkatësisë.

Investimet në kulturë e rrisin cilësinë e jetës dhe dinjitetin njerëzor, gjatë katër viteve do të vazhdojmë me investime dhe politika të rëndësishme që e rrisin nivelin e kulturës në komunën tonë.

1. E-BIBLOTEKA - Do të digjitalizojmë shërbimet në Bibliotekën e Qytetit dhe do të krijojmë një bibliotekë digjitale. Në bashkëpunim me Bibliotekën Kombëtare, shumë libra të disponueshëm në platformat digjitale do të jenë në shërbim të lexuesve përmes E-Bibliotekës së Komunës së Podujevës.

2. Biblioteka të hapura në parqe dhe ne oborre të shkollave - në parqe dhe në oborre të shkollave do të krijohen hapësira që do jenë në shërbime të lexuesve, duke krijuar mundësi të mira për lexim e studim në natyrë.

3. Renovimi i të gjitha objekteve të trashëgimisë kulturore - të gjitha objektet që janë të rëndësishë së veçantë dhe që bartin vlera të trashëgimisë kulturore, do të inkuadrojnë në listën e objekteve të mbrojtura, ku do rinovohen dhe do jenë në shërbim të qytetarëve.

4. Funkcionalizimi i ansamblit të qytetit – me qëllim të ruajtjes dhe kultivimit të vlerave kulturore do të krijohet ansambli i qytetit.

PODUJEVA PËR KULTURËN DHE SPORTIN

5. Rritja e subvencioneve për aktivitete kulturore - Do të rrisim ndarjen e mjeteve buxhetore për aktivitetet kulturore, me qëllim forcimin dhe pasurimin e jetës kulturore në komunën tonë, duke krijuar mundësi më të mëdha për organizimin e eventeve artistike dhe promovimin e traditave kulturore.

6. Ndërtimi i palestrës të sportive - në qytetin e Podujevës do të ndërtohet palestra sportive bashkëkohore, që do ju shërbej të gjitha klubeve sportive.

7. Qendër rekreative dhe sportive në Orlan, objekti i ndërtuar para shumë viteve të liqeni do të rinovohet dhe të kthehet në shërbim të komunitetit për organizimin e aktiviteteve sportive dhe rekreative.

8. Rritja e subvencioneve për klubet sportive - do të rriten fondet për klubet sportive në mënyrë që të krijohen kushte me të mira për zhvillimin e sportit.

PODUJEVA PËR KULTURËN DHE SPORTIN

9. Ndërtimi i qendrave multifunksionale sportive në qytet - do të ndërtohen qendra ku mund të zhvillohen shume sporte brenda saj.

10. Krijimi i ligave sportive komunale - Do të krijohen liga sportive komunale në sporte të ndryshme si: futboll i vogël, basketboll, hendboll, volejboll, pingpong, tenis, shah etj. Kjo do të ndikojë në rritjen e aktiviteteve sportive dhe në nxjerrjen e talentëve të ri.

105 · Lëvizja VETËVENDOSJE!

Shpejtim Bulliqi